



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

MINISTRI

Nr. 1442 prot.

Tiranë, më 14 / 03 / 2020

URDHËR

Nr. 173, datë 14.03.2020

PËR

**NDALIMIN E TË GJITHA LËVIZJEVE TË MJETEVE TË TRANSPORTIT NË  
PIKAT KUFITARE TOKËSORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, gërmat "a" të Ligjit Nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, Vendimin e Komitetit të përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

**URDHËROJ:**

1. Ndalimin e lëvizjeve me mjetet e transportit për udhëtarët (autobuza, autovetura etj), në hyrje dhe në dalje në pikat e kalimit kufitar tokësor duke filluar nga ora 23:59 e dt 15.03.2020. Ky kufizim do të qëndrojë në fuqi deri në një urdhër të dytë të Ministrit Përgjegjës për Shëndetësinë.
2. Përjashtim nga rregulli i caktuar në pikat 1 bëjnë mjetet e transportit për mallrat, produkte ushqimore, barna dhe pajisje mjekësore dhe produkte të tjera të nevojshme për shërbimin shëndetësor.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të bashkëpunojnë me Autoritetet përgjegjëse për kufirin dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

**Ogerta Manastirliu**

